



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 14, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 3, te Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, e konform nenit 6, pika 3, lidhur me nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe neneve 15, 29, pika 2 te Statutit të Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 30.10.2020 miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

**JEPET PËLQIMI-** për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër deri 10, (dhjetë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës, si vijon:

**1.1** Parcela **P-72116045-00984-0** me sipërfaqe të përgjithshme prej **704372m<sup>2</sup>**, sipas certifikatës së pronës **nr.11-463-1682/2020**, datës 10.06.2020, zona kadastrale **Studençan**, vendi i quajtura **“Trav/Çestok”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme jepen në shfrytëzim pjesët e parcelës si më poshtë

**1.1.1** Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **S=120960m<sup>2</sup>** për thyerjen dhe eksploatimin e gurit (vendosjen e gurthyesit).

**1.1.2** Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **S=115740m<sup>2</sup>** për thyerjen dhe eksploatimin e gurit (vendosjen e gurthyesit).

**1.1.3** Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **S=23646m<sup>2</sup>** për thyerjen dhe eksploatimin e gurit (vendosjen e gurthyesit) dhe

**1.2** Parcela **P-72116045-00739-0** me sipërfaqe të përgjithshme prej **246151m<sup>2</sup>**, sipas certifikatës së pronës **nr.11-463-1682/2020**, datës 10.06.2020, zona kadastrale **Studençan**, vendi i quajtura **“Mali Grab”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme jepen në shfrytëzim pjesët e parcelës si më poshtë;

**1.2.1** Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **S=112659m<sup>2</sup>** për thyerjen dhe eksploatimin e gurit (vendosjen e gurthyesit).

**1.2.2** Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **S=65240m<sup>2</sup>** për thyerjen dhe eksploatimin e gurit (vendosjen e gurthyesit).

**1.2.3** Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **S=55077m<sup>2</sup>** për thyerjen dhe eksploatimin e gurit (vendosjen e gurthyesit).

## Neni 2

**OBLIGOHET**-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e ankandit publik, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

## Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”), nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr- 016-53055  
Më datë 30.10.2020



Kryesuesi i Kuvendit

*[Signature]*  
Mr.ec Bexhet KUÇI